



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 3687 Prot

Lezhë, më 21 / 3 /2024

**R A P O R T**  
**PËR PUNËN/VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**  
**PËR VITIN 2023**

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisjes bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë.

Theksojmë që viti 2023 ishte vit zgjedhor, ku është bërë dhe ndryshimi i përbërjes së këshillit bashkiak, sipas rezultateve të zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023.

Këshilli i Bashkisë Lezhë, gjatë vitit 2023, është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur, për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit.

Këshilli ka marrë dhe vendime që i kushtoheshin familjeve me probleme të thella sociale, eliminimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, trajtimin me bursë të nxënësve si dhe vendime për rregullimin e jetës social-kulturore të bashkisë.

Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, nga fondi i kushtëzuar si më poshtë :

Nr.	Muaji	Ndihmë ekonomike për familje nga Fondi i kushtëzuar 6 %. (Nr. i familjeve)
1	JANAR	94
2	SHKURT	94
3	MARS	96
4	PRILL	98
5	MAJ	97
6	QERSHOR	100
7	KORRIK	99
8	GUSHT	97
9	SHTATOR	97
10	TETOR	95
11	NËNTOR	96
12	DHJETOR	94



**Për periudhën Janar – Dhjetor 2023, janë marrë 126 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Lezhë, ku 40 vendime janë me legjislaturën 2019-2023 dhe 86 vendime janë me këshillin e ri.**

Vlen për t'u theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Lezhë kanë qenë konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, gjë e cila shikohet edhe nga konfirmimi i ligjshmërisë së akteve nga Prefekti i Qarkut Lezhë për të gjitha vendimet e marra. Në lidhje me këtë, theksojmë bashkëpunimin e vazhdueshëm me Sektorit Juridik të institucionit të Prefektit.

Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë, për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Bashkisë Lezhë.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qënë mjaft aktiv, duke mbajtur mbledhjet e radhës, sipas tabelës së mëposhtme :

Muaji	Nr. i mbledhjeve	Mbledhje të Radhës	Mbledhje jashtë radhe	Mbledhje të Jashtëzakonshme
JANAR	1	1 (31.01.2023)	-	-
SHKURT	1	1 (21.02.2023)	-	-
MARS	1	1 (29.03.2023)	-	-
PRILL	1	1 (25.04.2023)	-	-
MAJ	1	1 (10.05.2023)	-	-
QERSHOR	2	1 (20.06.2026)	-	1 (26.06.2023) (mbledhja e konstituimit të këshillit të ri)
KORRIK	2	1 (27.07.2023)	1 (12.07.2023) (mbledhje organizative)	-
GUSHT	1	1 (30.08.2023)	-	-
SHTATOR	1	1 (28.09.2023)	-	-
TETOR	1	1 (31.10.2023)	-	-
NËNTOR	1	1 (30.11.2023)	-	-
DHJETOR	2	2 (14.12.2023) (mbledhja e buxhetit) (27.12.2023)	-	-
<b>GJITHSEJ</b>	<b>15</b>	<b>13</b>	<b>1</b>	<b>1</b>

- Vlen të përmendet, kontributi i anëtarëve të këshillit, që janë në përbërje të Komisioneve të Përhershme të këshillit bashkiak.
- Gjatë vitit **2023** janë zhvilluar, **9 mbledhje online në facebook**.
- Rendi i ditës për çdo mbledhje të këshillit bashkiak, është publikuar të paktën **5 ditë**



para mbledhjes në ëeb-in e Bashkisë Lezhë si dhe në faqen e Këshillit të Bashkisë Lezhë në Facebook.

- Të gjitha vendimet e këshillit bashkiak, janë publikuar në ëeb-in e Bashkisë Lezhë dhe janë të aksesueshëm nga çdo qytetar pa pagesë.

*Është pasuruar në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, informacioni i Këshillit Bashkiak për publikun, në një kënd të caktuar nëpërmjet kartelave/tabelave të mëposhtme :*

- Të dhëna të përgjithshme për këshillin.
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak.
- Sekretari i Këshillit - kontaktet.
- 5 Rregulloret e Këshillit Bashkiak.
- Kalendari i Konsultimit Publik.
- Njoftimet për konsultimet publike.
- Regjistri i kërkesave dhe ankesave.
- Regjistri i brendshëm i peticioneve.
- Regjistri i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit.

Nga Sekretariati i Këshillit janë vënë në zbatim kërkesat e ligjit për njoftimet publike (si në faqen zyrtare të Bashkisë), në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), si dhe ato që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë.

Gjatë vitit 2023 i janë drejtuar KB Lezhë gjithsej 29 kërkesa të cilat kanë marrë përgjigje ose me anë shkresore, ose me vendimmarrje, sipas rastit.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014 “Për konsultimin Publik” gjatë vitit 2023, këshilli ka mundur të zhvillojë 6 dëgjesa publike me banorët e Bashkisë Lezhë, në bashkëpunim me administratën dhe kryetarin e bashkisë.

Këshilli nëpërmjet faqes së tij online ka hapur një rubrikë të konsultimeve me publikun si një nga mënyrat e pjesëmarrjes së komunitetit për të përcjellë shqetësimet e sugjerimet e tij.

Shpenzimet për mbarëvajtjen e punës së KB Lezhë për vitin 2023 kanë qenë 11988603 lekë, ku përfshihen paga, sigurime shoqërore, shpërblymjet e këshilltarëve e të kryetarëve të fshatrave dhe kancelari.

Gjatë vitit 2023, me ftesë të KB Lezhë, kemi mikpritur këshillat bashkiakë të Korçës, Fushë Kosovës dhe Shtimes, me të cilët kemi patur shkëmbim eksperiencash.

### **Themelohet AGKB Lezhë për mandatin e ri**

Gratë dhe vajzat këshilltare të Bashkisë Lezhë u bashkuan pa dallim orientimi politik, për të krijuar Aleancën e Këshilltareve të Bashkisë Lezhë. AGKB ka për qëllim fuqizimin e grave dhe vajzave këshilltare bashkiake dhe ndikimin e tyre në përmirësimin dhe hartimin e politikave lokale të favorshme për komunitetin, gratë dhe grupet e tjera të pafavorizuara në bashkinë



përkatëse.

Misioni i Aleancës është që të bashkojë gratë dhe vajzat, anëtare të këshillave bashkiake në Shqipëri, nga të gjitha partitë politike dhe të punojë për të zhvilluar dhe advokuar për përmirësim të legjislacionit, politikave dhe për nisma që i përgjigjen çështjeve që prekin nevojat e grave dhe komuniteteve, arrijten e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale. Aleanca synon të promovojë barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale, të drejta të barabarta, qasjen e barabartë në shërbime dhe mundësi ekonomike në qeverisjen lokale.

Aleanca e Grave dhe Vajzave Këshilltare të Bashkisë Lezhë zgjodhi edhe përfaqësueset e saj, zj. Donika Ndoj kryetare, Zj. Elsa Gazulli zv/kryetare dhe Zj. Rajmonda Prendaj sekretare, që së bashku do punojnë për avancimin e të drejtave të grave, vajzave dhe të gjitha shtresave në nevojë, për një komunitet më të qëndrueshëm, ku të gjithëve u krijohen shance të barabarta.

Në muajin Nëntor 2023 u zhvillua një trajnim 2-ditor përgatitor për anëtarët e KB Lezhë, i mundësuar nga AMVV dhe ASPA, asistuar nga projekti “Bashki të Forta”, me qëllim njohjen e pjesëmarrësve me legjislacionin themelor që rregullon veprimtarinë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri si dhe njohuritë bazë që i nevojiten një këshilltari për ushtrimin e detyrës së tij, si i zgjedhur nga komuniteti për t'i shërbyer atij.

**Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen;** gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si: diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimin dhe dhënien me qira të pronave, miratimin e standarteve e rregulloreve etj. me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të komunitetit.

Administratorët e njësive administrative, kryesitë e fshatrave, këshillat komunitare, duhet të bëhen pjesë e organizimit e mbështetjes së dëgjësive publike, ku nëpërmjet posterave, anketave të ndryshme bëhet e mundur tërheqja e mendimit të komunitetit dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje.


**Del si detyrë që çdo këshilltar;** për aktet normative, për të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Falenderimet, shkojnë për;

- Asistencën teknike dhe operacionale të Z. Hekuran Koka, koordinator i projektit “Bashki të Forta”.

Bashkëngjitur janë lista e vendimeve e regjistri i mbledhjeve të zhvilluara, për vitin 2023, si dhe rezultatet e anketimit vjetor për vlerësimin nga komuniteti të punës dhe rezultateve të këshillit.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

REGJISTËR I VENDIMEVE JANAR 2023 - DHJETOR 2023

TITULLI I VENDIMIT

Nr	Nr. Vendimi	Data	PREFEKTI
1	1	31.01.2023	Konfirmim
2	2	31.01.2023	“
3	3	31.01.2023	“
4	4	31.01.2023	“
5	5	31.01.2023	“
6	6	31.01.2023	“
7	7	31.01.2023	“
8	8	21.02.2023	“
9	9	21.02.2023	“
10	10	21.02.2023	“
11	11	21.02.2023	“
12	12	21.02.2023	“
13	13	21.02.2023	“
14	14	21.02.2023	“
15	15	29.03.2023	“
16	16	29.03.2023	“







	qirasë për vitin 2023”			
39	“Për përdorimin e fondit të emergjencës për financimin e projektit “Forcimi i Kapaciteteve të Shërbimit Shqiptar të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”	39	10.05.2023	“
40	“Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Maj 2023”	40	20.06.2023	“
41	“Për ngritjen e komisionit të verifikimit të mandateve të këshilltarëve të Këshillit të Bashkisë Lezhë”	1	26.06.2023	“
42	“Për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Lezhë”	2	26.06.2023	“
43	“Për ngritjen e komisionit të votimit për zgjedhjen e kryetarit, zëvendëskryetarëve dhe përfaqësuesve të Këshillit të Bashkisë Lezhë në Këshillin e Qarkut Lezhë”	3	26.06.2023	“
44	“Për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit të Bashkisë Lezhë”	4	26.06.2023	“
45	“Për zgjedhjen e zv/kryetarëve të Këshillit të Bashkisë Lezhë”	5	26.06.2023	“
46	“Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit të Bashkisë Lezhë në Këshillin e Qarkut Lezhë”	6	26.06.2023	“
47	“Për disa ndryshime në Vendimin nr.54, datë 28.04.2020 ”Për miratimin e rregullores së Këshillit të Bashkisë Lezhë”	7	12.07.2023	Konfirmim
48	“Për miratimin e komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Lezhë dhe përbërjes së tyre”	8	12.07.2023	“
49	“Për heqjen e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Vincens Tuku”	9	12.07.2023	“
50	“Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Qershor 2023”	10	27.07.2023	“
51	“Për një shtesë në vendimin nr. 4, datë 3.1.01.2023 “Për miratimin e listës së të pastrehëve që përfitojnë subvencionim të qirasë për vitin 2023”	11	27.07.2023	“
52	“Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të akorduar për rritjen e pagave”	12	27.07.2023	“
53	“Për miratimin e pagave të administratës së bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve të varësisë, të punonjësve të njësive mbështetëse, të masës së shpërbërimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave”	13	27.07.2023	“
54	“Për një ndryshim në VKB nr. 13, datë 21.02.2023 “Për miratimin e kërkesës për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tek Bashkia Lezhë, të objektit Ish Materniteti Lezhë, pasuria me nr. 3/51, 3/52, zona kadastrale 8632”	14	27.07.2023	“
55	“Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të z. Pjetër Prela, brenda territorit të Bashkisë Lezhë”	15	27.07.2023	“
56	“Për përdorimin e Fondit të Kontingjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2023”	16	27.07.2023	“
57	“Për një ndryshim në vendimin e KB nr. 120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023”	17	27.07.2023	“
58	“Për miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë Lezhë për 4-mujorin e parë të vitit 2023”	18	27.07.2023	“
59	“Për miratimin e PBA-së 2024-2026 të Bashkisë Lezhë (Faza e Parë)”	19	27.07.2023	“
60	“Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2024-2026 (Faza e Dytë) të Bashkisë Lezhë”	20	27.07.2023	“
61	“Për heqjen e mandatit si anëtar e Këshillit të Bashkisë Lezhë znj. Miranda Dodaj”	21	27.07.2023	“
62	“Për heqjen e mandatit si anëtar e Këshillit të Bashkisë Lezhë znj. Justina Gjushi”	22	27.07.2023	“
63	“Për heqjen e mandatit si anëtar e Këshillit të Bashkisë Lezhë znj. Xhovana Gjokhilaj”	23	27.07.2023	“
64	“Për heqjen e mandatit si anëtar e Këshillit të Bashkisë Lezhë znj. Kleventina Lleshi”	24	30.08.2023	“



65	“Për dhënien e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Shtjefen Lleshi”	25	30.08.2023	“
66	“Për heqjen e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Ibrahim Demi”	26	30.08.2023	“
67	“Për heqjen e mandatit si anëtarë e Këshillit të Bashkisë Lezhë znj. Elodia Mali”	27	30.08.2023	“
68	“Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Korrik 2023”	28	30.08.2023	“
69	“Për miratimin e Rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e Strukturave Komunitare në Bashkinë Lezhë”	29	30.08.2023	“
70	“Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të akorduar për rritjen e pagave”	30	30.08.2023	“
71	“Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të emergjencës për “Rindërtimin e urës në fshatin Kodër Mulliri, Njësia Administrative Shëngjin”	31	30.08.2023	“
72	“Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin e KB nr. 120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023”	32	30.08.2023	“
73	“Për përdorim fondi për mbështetje financiare për familjen e z. Alfred Deda”	33	30.08.2023	“
74	“Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit për vitin 2023 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”	34	30.08.2023	“
75	“Për mosdhënien e mandatit si anëtarë e Këshillit të Bashkisë Lezhë znj. Adelina Toma”	35	28.09.2023	“
76	“Për mosdhënien e mandatit si anëtarë e Këshillit të Bashkisë Lezhë znj. Vera Deda”	36	28.09.2023	”
77	“Për mosdhënien e mandatit si anëtarë e Këshillit të Bashkisë Lezhë znj. Flora Margjonaj”	37	28.09.2023	”
78	“Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Gusht 2023”	38	28.09.2023	”
79	“Për një ndryshim në Vendimin e KB nr. 120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023” dhe përdorim të fondit të kontingjencës”	39	28.09.2023	”
80	“Për miratimin e PBA-së 2024-2026 të Bashkisë Lezhë (Faza e Dytë)”	40	28.09.2023	”
81	“Për miratimin e Planit Tematik Vjetor të Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2024”	41	28.09.2023	”
82	“Për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë dhe të kryetarëve të fshatrave si dhe miratimin e lagjeve për çdo fshat në Bashkinë Lezhë”	42	28.09.2023	”
83	“Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK”	43	28.09.2023	”
84	“Për dhënie “Çertifikatë Mirënjohje”, z. Sami Hoxha”	44	28.09.2023	”
85	“Për dhënien e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Emirjon Mali”	45	31.10.2023	Konfirmim
86	“Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Shtator 2023”	46	31.10.2023	“
87	“Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasit F.G.J.T., F.P.M. DHE I.R.K. nga fondi i emergjencës”	47	31.10.2023	“
88	“Për miratimin e përmbajtjes dhe modeleve të akteve për kundërvajtjet në pyje”	48	31.10.2023	“
89	“Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023”	49	31.10.2023	“
90	“Për miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë Lezhë për 4 muajorin e dytë të vitit 2023”	50	31.10.2023	“
91	“Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 13, datë 27.07.2023 “Për miratimin e pagave të administratës së bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve të varësisë, të punonjësve të njësive mbështetëse, të masës së shpërbllimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave”	51	31.10.2023	“
92	“Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara, vendbazeve ujore dhe zonave të shërbimeve në vijën	52	31.10.2023	“



	bregdetare Shëngjin dhe Tale për sezonin turistik veror 2024”			
93	“Për miratimin e Komisionit Qendror për Monitorimin e Zgjedhjeve të Strukturave Komunitare në Bashkinë Lezhë”	53	31.10.2023	“
94	“Për ndryshimin e emërimit të rrugës nga “Çamëria” në “Zef Toma””	54	31.10.2023	“
95	“Për ndryshim dhe emërim rrugësh në fshatin Gajush”	55	31.10.2023	“
96	“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” z. Frano Kulli”	56	31.10.2023	“
97	“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” z. Ismet Zusi”	57	31.10.2023	“
98	“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” Z. Nikolin Ivanaj”	58	31.10.2023	“
99	“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” Z. Marash Marku”	59	31.10.2023	“
100	“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” Z. Qemal Minxhozi”	60	31.10.2023	“
101	“Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” Z. Salvador Gjeçi”	61	31.10.2023	“
102	“Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqes së fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Lezhë, për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në legjislacionin në fuqi për pyjet”	62	31.10.2023	“
103	“Për mosmiratimin e liberalizimit të tarifave të ujit të pijshëm, grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura”	63	31.10.2023	“
104	“Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaltiteteve ndaj kundravajtësve”	64	31.10.2023	“
105	“Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Tetor 2023”	65	30.11.2023	“
106	“Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasin L.L.G. nga fondi i emergjencës”	66	30.11.2023	“
107	“Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasin A.D. nga fondi i emergjencës”	67	30.11.2023	“
108	“Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 8, datë 12.07.2023 “Për miratimin e komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Lezhë dhe përbërjes së tyre”	68	30.11.2023	“
109	“Për dhënien e mandatit si anëtare e Këshillit të Bashkisë Lezhë zj. Silvana Kastriot Kola”	69	14.12.2023	“
110	“Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2024”	70	14.12.2023	“
111	“Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtimin e resortit turistik nga kompania “Gjergji shpk””	71	14.12.2023	“
112	“Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK”	72	14.12.2023	“
113	“Për përfundimin e procedurave për kalimin në pronësi nga Bashkia Lezhë tek subjektet përfituese, të njëjste të banimit në ndërtesën (pallat) në lagjen “Besëlidhja”, të rindërtuar për shkak të tërmetit”	73	14.12.2023	“
114	“Për miratimin e linjave të transportit të nxënësve e mësuesve, qendrave të grumbullimit e biletave””	74	14.12.2023	”
115	“Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Nëntor 2023”	75	27.12.2023	”
116	“Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2023”	76	27.12.2023	”
117	“Për miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2025-2027 dhe të Buxhetit të vitit 2025”	77	27.12.2023	”
118	“Për një shtesë dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të akorduar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”	78	27.12.2023	”
119	“Për miratimin e zgjedhjes së anëtarëve të kryesive dhe të kryetarëve të fshatrave në Bashkinë Lezhë”	79	27.12.2023	”
120	“Për miratimin e bursave të nxënësve të regjistruar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin	80	27.12.2023	”



121	shkollor 2023-2024” “Për trajtimin me bursë të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2023-2024”	81	27.12.2023	”
122	“Për rishqyrtimin dhe miratimin e bursave të nxënësve të viteve të ndërmjetme, të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, për vitin shkollor 2023-2024”	82	27.12.2023	”
123	“Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Bashkisë së Veronës dhe Bashkisë Lezhë për projektin “Rigjenerimi i hapësirës publike përmes krijimit të qendrave të integruara të sporteve për pjesëmarrjen e të rinjve” (RE-GEN), në kuadër të programit URBACT IV”	83	27.12.2023	«
124	“Për emërtimin e shkollës 9-vjeçare Pllanë me emrin “Ndue Smaçi”	84	27.12.2023	«
125	“Për dhënie “Certifikatë Mirënjohje”, Z. Marjan Ndoja”	85	27.12.2023	«
126	“Për heqjen nga kontabiliteti i debitorëve që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor”	86	27.12.2023	«







# Pyetesor per vlerësimin e punës së Këshillit Bashkiak Lezhë

Ky pyetesor ka për qëllim të bëjë një vlerësim të punës së Këshillit Bashkiak Lezhë nga ana e qytetarëve. Mandati i Këshillit Bashkiak sapo ka filluar, dhe për ne, është e rëndësishme që qytetarët të bëjnë një vlerësim të punës tonë për vitin që sapo kaloi. Pyetëtori është anonim, kështu që për ne është e rëndësishme të marrim një vlerësim real të punës, pasi kjo do të na shërbejë për të përmirësuar punën tonë gjatë vitit që vjen.

1. ju jeni?

*Mark only one oval.*

Burrë

Grua

2. Moshja juaj?

*Mark only one oval.*

nën 18 vjeç

18-35 vjeç

36-65 vjeç

mbi 65 vjeç



3. A mendoni se Këshilli Bashkiak ka siguruar transparencë të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak?

*Mark only one oval.*

- po, shumë transparent
- mjaftueshëm transparent
- pak transparent
- aspak transparent

4. A mendoni se Këshilli Bashkiak ka mjaftueshëm informacion në faqen e bashkisë, seksioni Këshilli bashkiak?

*Mark only one oval.*

- shumë informacion
- mjaftueshëm informacion
- pak informacion
- aspak informacion

5. A mendoni që faqja e Facebook Këshilli i Bashkisë Lezhë, ka qene aktive me informacione për Këshillin?

*Mark only one oval.*

- shumë aktive
- mjaftueshëm aktive
- pak aktive
- aspak aktive



6. A keni marrë pjesë në ndonjë konsultim publik të akteve të Bashkisë?

*Mark only one oval.*

- Po  
 jo

7. Si i vleresoni konsultimet publike të Këshillit Bashkiak, për buxhetin, për pronat publike, etj kur bëhet fjalë për ndjekjen e interesit të qytetarëve?

*Mark only one oval.*

- shumë mirë  
 mirë  
 dobët  
 shumë dobët

8. A i keni adresuar ndonjë kërkesë apo ankesë Këshillit Bashkiak?

*Mark only one oval.*

- Po  
 jo

9. A keni marrë përgjigje për kërkesën apo ankesën drejtuar Këshillit Bashkiak?

*Mark only one oval.*

- Po, te rregullt  
 përgjigje jo shumë të qartë  
 përgjigje aspak të qartë  
 nuk kam marrë përgjigje



10. Çfarë mendoni se duhet përmiresuar në punën e Këshillit të Bashkisë Lezhë?

---

---

---

---

---

11. Vlerësoni me notë punën e Këshillit Bashkiak nga 1-5 ku (1 është notë minimale, dhe 5 është notë maksimale?)

*Check all that apply.*

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5

---

This content is neither created nor endorsed by Google.

Google Forms



# Pyetesor per vlerësimin e punës së Këshillit Bashkiak Lezhë


23 responses

[Publish analytics](#)

ju jeni?

 Copy


20 responses



Mosha juaj?

 Copy

20 responses






A mendoni se Këshilli Bashkiak ka siguruar transparencë të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak?

 Copy


21 responses



A mendoni se Këshilli Bashkiak ka mjaftueshëm informacion në faqen e bashkisë, seksioni Këshilli bashkiak?

 Copy

22 responses








Copy

A mendoni që faqja e Facebook Këshilli i Bashkisë Lezhë, ka qene aktive me informacione për Këshillin?


22 responses



Copy

A keni marrë pjesë në ndonjë konsultim publik të akteve të Bashkisë?

22 responses









Si i vleresoni konsultimet publike të Këshillit Bashkiak, për buxhetin, për pronat publike, etj kur bëhet fjalë për ndjekjen e interesit të qytetarëve?

20 responses



A i keni adresuar ndonjë kërkesë apo ankesë Këshillit Bashkiak?

21 responses








## A keni marrë përgjigje për kërkesën apo ankesën drejtuar Këshillit Bashkiak?

15 responses



## Çfarë mendoni se duhet përmiresuar në punën e Këshillit të Bashkisë Lezhë?

11 responses

faqja web ka ende nevojë për informacion

Ndoshta kohezgjatja e mbledhjes dhe webi të jete me l plote, me l permiresuar

degjesat publike duhet të arrijne me shume qytetare

Te punohet ne interes te qytetareve dhe jo te interesave individuale apo partike

Asnje gje

Me shume pjesemarrje

Te jete me e madhe pjesmarrja ne mbledhje

Këshilltarë të veçantë të jenë më aktiv në mbledhjet e këshillit, por dhe në takimet e konsultimeve publike.

Nderveprimi me qytetaret

Te vazhdoje e te jete transparent

Perfshirja e te rinjve ne vendimmarrje








Vlerësoni me notë punën e Këshillit Bashkiak nga 1-5 ku (1 është notë minimale, dhe 5 është notë maksimale?)

22 responses



This content is neither created nor endorsed by Google. [Report Abuse](#) - [Terms of Service](#) - [Privacy Policy](#).

Google Forms





